



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 30/2015

Prishtinë, më 15.9.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa - kryetar, Sasha Milosavleviq, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca, Enver Hoti dhe Duda Balje - anëtarë.

Munguan: Visar Ymeri dhe Pal Lekaj - anëtarë.

Pjesëmarrës të ftuar: Hykmete Bajrami, ministre e Tregtisë dhe Industrisë; Besa Zogaj – Gashi, zëvendësministre e Zhvillimit Ekonomik.

Pjesëmarrës të tjerë: Rexhep Bllaca dhe Bashkim Navakazi - MTI; Fazile Bekteshi, Luan Morina dhe Dukagjin Shala - MZHE; Lumnije Murati - ZPRK; Njomza Zejnullahu - ECS/USAID; Visar Rushiti - GAP; Dardan Abazi – INDEP; Lejla Selimi – OSBE dhe Arben Sylejmani - Bota Sot.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina dhe Nurie Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 28 dhe 30.07.2015;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-057 për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-058 për Dizajnin Industrial;
5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-052 për Energjinë Termike;
6. Shqyrtimi i nismës legjislative “Projektligji për siguri në punë në miniera”;
7. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 28 dhe 30.07.2015

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 28 dhe 30.07.2015 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-057 për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, tha se për këtë pikë të rendit të ditës është e ftuar znj. Hykmete Bajrami, ministre e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, dhe propozoi që së pari të paraqesë arsyetimin e Projektligjit nr. 05/L-057 për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore dhe pastaj të hapim debatin. Pastaj kryetari e vlerësoi këtë projektligj, sepse më këtë projektligj krijohet një pako e masave nga sfera e financave dhe përmirësimit të klimës për biznese dhe krijohet një lehtësim i qasjes në financa të mikrondërmarrjeve, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe, ky është një moment i ri në këtë sferë dhe falenderoi ministrinë dhe Qeverinë për këtë iniciativë ligjore.

Hykmete Bajrami, ministre e Tregtisë dhe Industrisë, tha se synimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës është procedimi i përshpejtuar i pakos legjislative dhe reformës administrative në funksion të përmirësimit të ambientit biznesor. Pra, qëllimi i këtij projektligji është që të rritet mundësia e financimit për kategori të caktuara të bizneseve që e kanë pasur të vështirë të marrin financim nga bankat. Këtu e kam fjalën në radhë të parë për bizneset e grave, të fermerëve, të prodhuesve vendorë, të ndërmarrësve që dëshirojnë të fillojnë një biznes apo të zgjerojnë një biznes ekzistues, etj. Për shkak të perceptimit që kanë bankat në lidhje me nivelin e rrezikut për kthimin e kredive, ato kanë kërkesa të atilla të cilat konsiderohen si joproporcionale nga biznesi, qoftë për sa i përket kërkesës për kolateral apo edhe normave të interesit që ato aplikojnë. Fondi do të mbulojë deri në 50 për qind të kolateralit dhe kjo do t'i bëjë bankat më komode në aprovimin e kredive për bizneset të cilat e kanë të pamundur garantimin e kërkesave kreditore me asetet vetanake. Kjo përqindje mund të rishikohet pas një periudhe të caktuar kohore, varësisht nga gjendja financiare e Fondit. Por fillimisht është menduar që të jetë në këtë nivel në mënyrë që të ofrohen sa më shumë garancione dhe të lëshohen më shumë kredi nga bankat. Megjithatë qëllimi kryesor i Fondit nuk është që të ulë normat e interesit, ne besojmë që institucionet bankare dhe jobankare, si dhe ato mikrofinanciare do të reflektojnë edhe në këtë aspekt duke i bërë ofertat e tyre për bizneset më të favorshme se ato ekzistuese. Sidoqoftë, ne jemi të vetëdijshëm që bankat duhet të paguajnë një kosto shtesë për shërbimet garantuese të Fondit. Fondi Kosovar për Garanci Kreditore do të jetë një institucion i pavarur, autonom, i cili do të funksionojë në bazë të ligjeve të Republikës së Kosovës, do të ketë përgjegjësinë e plotë në bazë të ligjit për qeverisje kooperative, kontabilitetin, auditimin dhe raportimin, dhe në këtë aspekt ai është pak a shumë analog me fondin për sigurimin e depozitave, i cili me sa jam e informuar po funksionon mjaft mirë. Ka pasur edhe ide që Fondi të bëhet në partneritet me sektorin privat, por me përjashtim të një banke vendore, të tjerat nuk kanë treguar interesim. Për mendimin tim, pjesëmarrja e kapitalit privat në Fond, sidomos nga sektori bankar do të mund të gjeneronte konflikt interesi në menaxhimin e tij. Kështu që në formatin e tanishëm, me mbikëqyrjen rigorozë nga Banka Qendrore e Kosovës, besoj që Fondi do të arrijë të ruaj pavarësinë operationale dhe të menaxhojë me kujdes portfolion e tij. Një arsye tjetër për prioritetin e lartë për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore është fakti se donatorët ndërkombëtarë janë zotuar se do të japin mbi 20 milionë dollarë amerikan/18 milionë

euro si asistencë teknike për të zhvilluar dhe implementuar Fondin Kosovar për Garanci Kreditorë (FKGK), si dhe për të financuar kapitalin për të mbështetur garancitë. Është esenciale që FKGK të themelohet sa më shpejt që të jetë e mundur në mënyrë që të kapitalizohen fondet në fjalë dhe të arrihet një rritje ekonomike dhe punësim. Në rast se themelimi i FKGK do të vonohej dhe nuk do të ndodhte brenda vitit 2015 fondet e donatorëve mund të mos jenë më në dizpozicion. Fondi, llogaritet që diku në gjashtë vitet e para do ta rrisë mundësinë për kredi të reja në rreth 360 milionë euro dhe pritet që nga huatë e reja të mund të krijohen deri në 20 mijë vende të reja të punës. Raporti i Progresit nga Komisioni Evropian për Kosovën, i vitit 2014, gjithashtu thekson që qasja e kufizuar në financa është një prej sfidave kryesore të zhvillimit të NMVM-ve dhe rritjes së mëtutjeshme, ndërsa në Raportin e Bankës Botërore “Doing Business Report”, Kosova ka rënë tek indikator i marrjes së kredive nga vendi i 19-të më 2014 në të 23-tin në vitin 2015.

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, tha se duket qartë se intenca që të rritet vëllimi i investimeve nepërmes lehtësimit të qasjes në financa për bizneset që kanë pas problem, qoftë për shkak të mungesës së kolateralit dhe hipotekave, qoftë për shkak të kohës kur ato fillojnë biznesin. Në këtë drejtim është më rëndësi që në ligj të theksohet se prioritetet si gratë, viset e pazhvilluara dhe mund të mbështes bizneset që fillojnë, pra startup-et sepse e kanë problemin me të madh me marr kredi. Çështja tjetër në punën e mëtejme duhet të shikojmë se sa mund ta absorbojmë sa ma shumë ato përvoja ku këto fonde kanë qenë të suksesshme, sepse ka praktika kur këto fonde nuk kanë rezultuar të suksesshme. Një nga çështjet që duhet të adresohet në mes dy leximeve është disa kritere për tarifat për garancitë.

Besim Beqaj tha se është një Ligj mjaft i rëndësishëm dhe fokusi kryesor duhet të jetë te startup-et. Neve na intereson ta dijmë përafërsisht se me 1 milion garanci sa do të jepen kredi. Çështja tjetër është unë mendoj duhet t'i kemi dy kritere, kriteret e investimeve mbi çfarë bazë duhet të bëhen dhe në cilin sektor duhet të investohet, dhe mendoj se duhet të mbështete sektori prodhues. Duhet të kemi kujdes dhe mos të krahasojmë këtë fond me fondin e garancimit të depozitave dhe mendoj se vetëm një bord nuk mund ta kryejë vetëm këtë punë. Pra, bartja e rrëzikut është një element kryesor në themelimin e fondeve. Në parim e përkrahi këtë projektligj, ndërsa në mes dy leximeve do t'i japim vërejtjet tona.

Blerim Grainca e përkrahu procedimin e këtij projektligji dhe përpjekjet e Qeverisë për të përmirësuar klimën e të bërit biznes, si dhe reformave ekonomike dhe fiskale. Ne duhet t'i mbështesim bizneset sepse ato kanë problem në qasje e financa, sepse janë kushtet e pa përballueshme të biznesit duke marrë parasysh normën e interesit të lartë nga bankat dhe sigurimin e kolateralit. Shtoj se duhet të futet më shumë kapitali privat në strukturën e pronsisë së fondit, sepse mund të ketë investitor të tjerë të cilët kanë interes për të qenë në këtë fond. Këtu parashihet që në gjashtë vitet e para të krijohen 20 mijë vende të punës dhe të krijojë 280 mijë euro profite, por s' di se sa do t'i mbulojë operimet e veta. Po ashtu me rëndësi është edhe ndarja e riskut e trekëndshit në mes të Qeverisë, Bankave dhe Kompanive dhe pyeti sa i dëmton kjo ndërmarrjet e vogla për të marrë kredi dhe ato të cilat nuk kanë mundësi të marrin kredi.

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, tha se nga diskutimi kemi disa gjëra esenciale që kanë dalë, andaj deri në leximin e dytë të projektligjit duhet të shikojmë së pari përgjegjësisinë për pagesë duhet ta mbajnë bankat deri në instancën e fundit. Prandaj mendoj se në atë pjesë duhet t'i shikojmë normat se kur një bankë është i kualifikuar që të pretendojë për të realizuar garancionet që sigurohen në këtë fond. Çështja tjetër është te kostoja tjetër e administrimit dhe duhet t'i shikojmë disa kritere, sepse disa fonde po na bëhen çerdhe të punësimit, dhe rentabiliteti i fondit duhet të jetë diskutabil. Po ashtu instrumentet e këtij fondi duhet të ndikojnë në uljen e normave të interesit me tutje, edhe pse nuk është qëllimi primar i këtij fondi dhe duhet të kemi kujdes te tarifat sepse me tarifa e vështirsojmë situatën e bizneseve, andaj duhet të

kemi disa kriterë bazë për këto tarifa. Gjithashtu mendoj se duhet të caktohet me Ligj mandati i anëtarëve të bordit të këtij fondi. Po ashtu duhet të sqarohet edhe çështja e dividendës dhe përfitimeve të këtij fondi dhe duhet të sqarohet se çka është natyra e këtyre përfitimeve.

Hykmete Bajrami, ministre e Tregtisë dhe Industrisë, dha sqarime për çështjet që u ngritën nga ana e deputeteve. Ajo tha se është vendosur që fondi të mbulojë 50% të kolateralit, dhe kjo e bën dallimin, ndërsa 50% mbetet mbulimi i rrezikut nga ana e bankave. Sa i përket tarifave është e vërtetë se duhet të jenë të arsyeshme për shkak se ne nuk duhet të demotivojmë bizneset që të mbulohen, mirëpo është komplet në diskrecion të bankat komerciale të përdorin të gjitha kriteret të cilat i përdorin edhe sot. Sa i përket administratës është menduar që fondi ta ketë strukturën e vet menaxhuese, mirëpo ata nuk janë shërbyes civilë. Tarifat është caktuar që të rregullohen me akt nënligjor dhe të mos jenë të larta, por të jenë të vetëmjaftueshme për t'i mbuluar shpenzimet operacionale dhe të stafit. Ky institucion do të mbikqyrët sikurse çdo institucion tjetër financiar nga Banka Qendrore e Kosovës. Anëtarët e bordit kanë mandat katër vjeçar dhe do të udhëhiqet me rotacion. USAID-i do të kontribuojnë në fillim me 14 milionë euro këto mjete të cilat përbëjnë kapitalin fillestar të këtij fondi, por ka institucione tjera donatore që do ta mbështesin këtë fond të cilët do t'i caktojnë përfaqësuesit e tyre në bord. Është vendosur që ky fond të invesojë aty ku mjetet janë qind për qind të sigurta dhe jo kujt do.

Besim Beqaj pyeti se ashtë menduar që tarifat t'i caktojë ky bord, apo duhet të verifikohen këto tarifa nga dikush?

Blerim Grainca pyeti a ka ide ministria që në të ardhmën e aftërt që ky fond të ofrojë edhe produkte të tjera?

Hykmete Bajrami, ministre e Tregtisë dhe Industrisë, tha se te tarifat është menduar që të caktohet me udhëzim administrativ dhe bordi t'i aprovojë ato me baza vjetore për shkak të inflacioneve etj, dhe tarifat do të jenë vetëm sa për t'i mbuluar shpenzimet siç thashë më parë. Sa i përket asaj që fondi të ofrojë edhe shpërbime të tjera është menduar që të mbetet e hapur ku qëllimi i Ligjit është ky, ndërsa në të ardhmën e afërt do të shohim mundësitë e tjera varësisht nga prioritetet e Qeverisë.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. Miratohet në parim projektligji nr.05/L-057 për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditorë;

2. I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim projektligjin nr.05/L-057 për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditorë;

3. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet, deputeti Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Grupi i punës për shqyrtimin e këtij Projektligji, pas miratimit të parim nga Kuvendi, do të jetë në këtë përbërje: Muhamet Mustafa, kryesues, Besim Beqaj dhe Enver Hoti,- anëtarë.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-058 për Dizajnin Industrial

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, tha se për këtë pikë të rendit të ditës është e ftuar znj. Hykmete Bajrami, ministre e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, dhe propozoi që së pari

të paraqes arsyetimin e Projektligjit nr.05/L-058 për Dizajnin Industrial dhe pastaj të hapim debatin.

Hykmete Bajrami, ministre e Tregtisë dhe Industrisë, tha se në vazhdimësi të plotësimit dhe ngritjes të infrastrukturës ligjore nga fusha e Pronësisë Industriale, Qeveria, gjegjësisht MTI, pas inicimit të procedurave të plotësimit dhe ndryshimit të Ligjit për Patenta, Ligjit për Marka Tregtare dhe Projektligji për Treguesit Gjeografik dhe për Emërtimet e Origjinës, ka përgatitur edhe Projektligjin për Dizajn Industrial, me qëllim të ndërtimit të një sistemi efikas për sigurimin e të drejtave të pronësisë intelektuale në Republikën e Kosovës, sistem i cili ka për qëllim mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të pronës intelektuale, përkatësisht asaj industriale. Në infrastrukturën ligjore të pronësisë industriale krahas arritjeve të mëdha janë vërejtur disa mangësi në ligjin aktual për Nr. 04/L-028 për Dizajnin Industrial që i përket zbatimit dhe mbrojtjes së të drejtave të dizajnëve industriale dhe harmonizimit jo të plotë të ligjit aktual me standardet e BE- në këtë fushë. Në këtë projektligj janë qartësuar dhe specifikuar qartë dispozitat që kanë të bëjnë me procedurat e regjistrimit, aplikimet me pronarë vendorë dhe atë të jashtëm, si dhe të drejtave që rrjedhin nga regjistrimi i dizajnëve industrial në Agjencinë për Pronësi Industriale, afatet procedurale, si dhe janë qartësuar dispozitat të cilat kanë të bëjnë me regjistrimin ndërkombëtar të dizajneve industriale, mbrojtjen gjyqësore dhe definimin e Gjykatës kompetente për mbrojtjen e dizajnit industrial. Projektligji i ri është hartuar plotësisht në harmoni me Direktivat Evropiane për mbrojtjen ligjore të dizajneve industriale, si dhe rregulloret e BE-së të cilat kanë të bëjnë me regjistrimin e dizajnëve industriale. Projektligji gjithashtu përmban dhe qartëson dispozita sa i përket zbatimit të të drejtave të dizajnit industrial dhe procedurat civile-juridike për mbrojtjen e të drejtave dizajnit industrial, e të cilat janë në përputhje të plotë me direktivat e BE-së, e që paraqet avancim të infrastrukturës ligjore në këtë fushë. Projektligji është hartuar në përputhje me procedurat e parapara me Rregulloren Nr. 09/2011 për Punën e Qeverisë së Kosovës dhe është pranuar Deklarata Financiare nga Ministria e Financave se nuk ka implikime shtesë buxhetore dhe Opinioni i Pajtuësshmërisë me Legjislacionin e BE-së nga MIE se projektligji i lartpërmendur është i harmonizuar me Acquis-in e BE-së. Propozimi i Projektligjit për dizajnin industrial ndërlidhet me objektivat e Qeverisë respektivisht të MTI-së. Përmes këtij projektligji sigurohet një mbrojtje më e mirë juridike për subjektet juridike, të cilët kërkojnë mbrojtje të aseteve të kompanive të tyre. Si rezultat i kësaj, miratimi i këtij ligji siguron një ambient akoma më të përshtatshëm për mbrojtjen e pronësisë industriale në Kosovë, që rrjedhimisht ndikon edhe në promovimin e investimeve të huaja. Me hyrjen në fuqi të këtij projektligji do të harmonizohen plotësisht ligjet nga Fusha e dizajneve industriale me direktivat e Bashkimit Evropian, si dhe hapet rruga për implementimin e dispozitave të tyre, gjë që do të ndikojë në qasjen më të lehtë të mbrojtjes së pronësisë industriale në Kosovë. Për fund dua të ju siguroj që Projektligji për dizajnin industria është draftuar në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare dhe evropiane dhe theksoj që miratimi i ndryshimeve dhe plotësimeve të këtij ligji është kusht që Kosova duhet plotësuar me rastin e nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit me BE-në. Në këtë marrëveshje në mënyrë specifike theksohet që Kosova obligohet që të ofrojë mbrojtje të njëjtë në fushën e pronësisë intelektuale, duke përfshirë edhe dizajnin industrial, me ato të vendeve të Bashkimit European. Prandaj, procedimi i këtij Projektligji është i rëndësishëm dhe ju propozojmë që ta shqyrtoni dhe miratoni në këtë mbledhje.

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, tha që më aprovimin e Projektligjit për dizajnin industrial po përmbylljet një pako e ligjeve që sigurojnë një mbrojtje të pronsisë industriale e cila është mjaft e rëndësishme për tërheqjen në fushën e mbrojtjen e dizajnit industrial dhe stimulimin e krijimtarisë në Kosovë. Ky Ligj i ka adresuar në mënyrë më të mirë sa i përket procedurave dhe përfarimit të legjislacionit evropian. Kërkojë sqarim lidhur me periudhën e mbrojtjes e cila është pesë vjet me kërkesë që mund të shtyhet deri në 25 vjet.

Hykmete Bajrami, ministre e Tregtisë dhe Industrisë, tha se ashtu është në projektligj dhe kjo është marrë nga legjislacioni i BE-së dhe kështu është e paraparë edhe në vende të tjera.

Blerim Grainca pyeti lidhur me nenin 11, ku thuhet se “dizajnues është personi fizik i cili ka krijuar dizajnin”, çka ndodh nëse “dizajnuesi” është institucion apo është person juridik?

Bashkim Navakazi, MTI, tha se dallimi prej objekteve tjera të pronsisë inturstriale, si marka dhe patenta është që të dizajni industrial duhet me qenë vetëm një individ për me bërë dizajnin, edhe nëse janë një grup i caktuar përsëri një person i cili përfaqëson grupin. Edhe në rast kur kemi një institucion publik apo privat duhet ta caktojë një person i cili bën mbrojtjen dhe përfaqësimin në emër të institucionit.

Besim Beqaj tha se të dyja këto çështje sikurse çështja e përfaqësimit në rast kur është grup apo institucion për ta marrë të drejtën e dizajnzuesit dhe çështja e periudhës 5 vjeçare me vazhdim të periudhës deri në 25 vjet në bazë të kërkesës, mendoj që duhet të diskutohet në mes të dy leximeve dhe të nxjerrim një konkluzion në bazë të analizave të sakta dhe kur të themi se jemi bazuar në praktikën më të mira duhet të na thuhet qartë se cilat janë ato Ligje dhe cilat janë ato vende nga të cilat janë marrë ato praktika të mira.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë :

R e k o m a n d i m

- 1. Miratohet në parim projektligji nr.05/L-058 për Dizajnin Industrial;*
- 2. I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim projektligjin nr.05/L-058 për Dizajnin Industrial;*
- 3. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet, deputeti Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.*

Grupi i punës për shqyrtimin e këtij Projektligji, pas miratimit të parim nga Kuvendi, do të jetë në këtë përbërje: Muhamet Mustafa, kryesues, Besim Beqaj dhe Enver Hoti,- anëtarë.

5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-052 për Energjinë Termike

Kryetari Muhamet Mustafa tha se për projektligjin për energjinë termike sot në Komision është e pranishme znj. Besa Zogaj – Gashi, zëvendësministre e Zhvillimit Ekonomik; e cila do ta prezantojë projektligjin, dhe ia dha fjalën asaj.

Besa Zogaj – Gashi, zëvendësministre e Zhvillimit Ekonomik, tha se si organ propozues i këtij ligji, Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE), sipas dispozitave të Rregullores së Punës së Qeverisë nr. 09/2011, ka zhvilluar procesin e konsultimeve paraprake dhe publike, ku drafti është dërguar për konsultim të institucionet si, ZKM, MMPH, MTI, ZRRE, MF, MIE, TERMOKOS dhe ngrohja e qytetit-SHA – Gjakovë, si dhe institucione të tjera. Një ndër objektivat që MZHE ka paraparë me hartimin e këtij Projektligji është krijimi i një tregu të lirë të furnizimit me energji termike dhe përcaktimi i kushteve dhe standardeve për kryerjen e aktiviteteve energjetike të prodhimit, transportimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji termike, përmes sistemeve qendrore të energjisë termike, dhe organizimin e tregut të energjisë termike, si dhe shfuqizimin e Ligjit nr. 03/L-116 për Ngrohjen Qendrore. Transpozimin e dispozitave të Direktivave përkatëse të BE- së me objektiv kryesor krijimin e kushteve për zhvillimin e tregut të qëndrueshëm dhe konkurrues për ngrohje/ftohje të përqendruar të energjisë termike, dhe

përcaktimi i kushteve që konsumatorët të gëzojnë të drejtë për t'u kyçur dhe furnizuar me energji termike sipas standardeve dhe me çmim ekonomik. Me këtë Projektligj përcaktohen kushtet për krijimi i një tregu të lirë dhe standardet për kryerjen e aktiviteteve energjetike të prodhimit, transportimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji termike, përmes sistemeve qendrore të energjisë termike, organizimin e tregut të energjisë termike dhe qasjen në rrjet, si dhe të drejtat dhe detyrimet e subjekteve që veprojnë sipas këtij ligji. Çështjet kryesore të trajtuara në këtë projektligj janë - përcaktimi i kushteve për zhvillimin e tregut të qëndrueshëm dhe konkurrues të energjisë termike (ngrohje/ftohje të përqendruar), sipas ekonomisë së tregut të lirë, duke plotësuar kërkesat e konsumatorëve dhe mbrojtjen e mjedisit- Përcaktimi i kushteve për furnizim të sigurt, të qëndrueshëm dhe eficient me energji termike, (ngrohjen/ftohjen) e hapësirave, ngrohjen e ujit sanitar dhe ujit industrial; dhe - Përcaktimi i kushteve që konsumatorët të gëzojnë të drejtë për t'u kyçur dhe furnizuar me energji termike sipas standardeve dhe me çmim ekonomik. Risit në ligjin për energjinë termike: Zgjerimi i fushës së rregullimit të tregut jo vetëm të ngrohjes, por edhe të ftohjes së hapësirave komerciale dhe të banimit.

Kryetari Muhamet Mustafa tha se ngrohja apo energjia termike ka rëndësinë e vetë dhe ky Ligj është bazuar në Ligjin në fuqi për Ngrohjen Qendrore me disa përmirësime. Është me rëndësi të diskutojmë sepse këtu flitet vetëm për furnizuesin publik, ndërsa neve na intereson se a do të ketë edhe këtu liberalizim të tregut sikurse edhe në sektorin energjetikë. Tha se nuk është qartësuar shthurja apo ka mbetur në gjysmë, kemi një shthurje të gjenerimit, ndërsa jo edhe të distribuimit, ndoshta do të na nevojitet këtë çështje ta shohim më tutje se si do ta rregullojmë. Edhe çështja e matjes është rregulluar, por sipas Direktivave të BE-së për Eficiencë kërkohet që çdo anëtar i BE-së deri më 31 dhjetor 2016 të ketë të instaluar matësit e ngrohjes termike, pyeti se a e kemi siguruar këtë?

Besim Beqaj tha se me këtë Ligj duhet ta definojmë çka nënkupton dhe cilat janë objektivat dhe përgjegjësit e operatorit të sistemit në kuptim me rrjetet deri ku është pronë e kujt, sepse ky Ligj e ndryshon krejt strukturën e furnizimit të energjisë termike dhe si është para, pastaj shpërndarja. Për kogjenerim furnizimin dhe prodhimin e energjisë elektrike e rregullon operatori i sistemit dhe shpërndarjes, prej kur del prej fabrikës- KEK-ut kush është ai që e rregullon? Dhe kush është ai i cili i cakton tarifat? Dhe pjesa tjetër është pjesa e liberalizimit a mendohet në liberalizim përmes ndermarrjeve publike siç është tani apo mendohet edhe të futen edhe ndermarrjet private?

Blerim Grainca pyeti nese futen edhe operatorët e tjerë privat në treg a janë të përgaditur për këtë?

Luan Morina, (MZHE), sqaroi se koncepti i rregullimit të energjisë termike me këtë projektligj është i njëjtë me mënyrën e rregullimit të energjisë elektrike. Pranoj që shthurja nuk është e qartë. Njehsorët janë kolektiv në objekte kolektive tha ai, ndërsa sa i përket licencimit të operatorëve ai tha se Rregullatori i Energjisë mund të licencojë më shumë operatorë.

Sala Berisha Shala tha se këtu u përmenden vetëm dy operatorë publikë të ngrohjes, ai i Prishtinës dhe i Gjakovës, të cilët janë konsultuar dhe shtoi se është edhe operatori i Mitrovicës dhe është në të mirë të rregullimit më të mirë të fushës së energjisë termike që mos të mbetet diçka pa u përfshirë dhe të mos bëhen kësi dallime në Ligj.

Kryetari Mustafa tha se nga diskutimet që u bënë çështjet që duhet të shikohen më shumë janë shthurja dhe çështja e tarifave. Ai tha se projektligjin ta procedojmë për lexim të parë në Kuvend dhe në mes të dy leximeve të japim kontributin tonë që sa ma mirë t'i rregullojmë kushtet për zhvillimin e tregut të energjisë termike.

Pas debatit, Komisioni njëzëri, nxori këtë:

P ë r f u n d i m

1. Miratohet në parim projektligji nr.05/L-052 për energjinë termike;

2. I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim projektligjin nr.05/L-052 për energjinë termike;

3. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet, deputeti Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Grupi i punës për shqyrtimin e këtij Projektligji, do të ketë këtë përbërje: Fatmir Rexhepi-kryesues, Sasa Milosavljeviq, Sala Berisha-Shala dhe Pal Lekaj anëtarë.

6. Shqyrtimi i nismës legislative “Projektligji për siguri në punë në miniera”

Kryetari Muhamet Mustafa tha se kryesuese e grupit punues për hartimin e projektligjit për sigurinë në punë në miniera është deputetja Sala Berisha –Shala dhe ia dha fjalën.

Sala Berisha-Shala tha se grupi punues është takuar një javë më parë, kemi marrë procesverbalet e diskutimeve i kemi shikuar vërejtjet dhe sugjerimet të cilat nuk kanë qenë diçka konkrete. Ajo tha se ta futim në procedurë, ta dërgojmë në Qeveri për dhënien e opinionit të saj, dhe më pas gjatë shqyrtimit në procedurë të rregullt mes dy leximeve kemi mundësinë që të diskutojmë ende dhe të bëjmë ndryshimet e nevojshme.

Besim Beqaj tha se ta procedojmë për opinion të Qeverisë ku edhe Ministria e Financave do të japë deklaratën financiare për vlerësimin e ndikimit financiar të projektligjit.

Blerim Grainca tha se gjobat e përcaktuara te neni 15 janë të vogla për shkeljet që munden me ndodhur, ku janë caktuara nga 5 mijë deri 10 mijë euro, si dhe te paragrafi 2 nga 3 mijë deri në 6 mijë euro dhe si të tilla nuk do të ndikojnë në preventivë të sigurisë në punë në miniera. Ai i rekomandoi grupit punues për hartimin e projektligjit të rriten gjobat dhe të gjendet një mekanizëm më i fuqishëm për parandalimin e shkeljeve, sepse shkeljet mund të krijojnë pasoja të mëdha degradim të lumenjeve, degradim të mjedisit.

Besim Beqaj lidhur me gjobat tha se flitet për hapa apo shkelje konkrete të cilat janë listuar në vazhdim të nenit për gjobat dhe nuk flasim për ndonjë penalizim sepse thuhet “në rast se” pra nëse e ka marrë licencën, por nuk i ka plotësuar kushtet e tjera, ndërsa përgjegjësia për lumenjt bie mbi inspektoratin përkatës.

Blerim Grainca tha se këtë që e deklarova më herët jam bazuar në raportin vjetor të KPMM-se, kur i kemi pasur të listuar diku 90 kompani ilegale të cilët operojnë pa kurrfarë kushte teknike.

Sala Berisha-Shala tha se është mirë që ky projektligj do të shkojë edhe në Ministrinë e Financave. Sa i përket gjobave, KPMM ka paraqitur si sfidë mbrojtjen nga degradimet të cilat bëjnë operatorët ilegale. Ndërsa, ky projektligj shtoi ajo është për sigurinë në punë në miniera, kurse çështjet e ngritura, si mbrojtjen nga degradimet rregullohet me ligjin për miniera dhe minerale.

Dukagjin Shala, (MZHE), tha se kam planifikuar t’i ngrisë disa çështje rreth projektligjit, por meqenëse projektligji do të vijë në Qeveri, përkatësisht në Ministri, ne do t’i japim komentet

tona atëherë kur të vijë në Ministri. Në fund kërkoi që titulli i projektligjit të ndryshohet dhe në vend të titullit ekzistues të bëhet “*Projektligji për sigurinë në punë në veprimtarinë minerare*”.

Kryetari Mustafa tha se në mbledhjen e Komisionit kur është diskutuar ky projektligj kemi nxjerrë konkluzat tona, ku kemi pasur vërejtje në afatet e inspektimit dhe kemi konstatuar që inspektimet në ndërmarrjet minerare të bëhen më shpesh, së paku dy herë në vit në ndërmarrjet minerare në përgjithësi, ndërsa kemi kërkuar që në ato me rrezikshmëri më të lartë të inspektohen çdo tre muaj, sepse preventiva është qëllimi i këtij projektligji.

Sala Berisha-Shala tha se këto inspektime janë inspektime gjenerale të cilat i bëhen ndërmarrjeve minerare, ndërsa inspektime mund të bëhen në çdo kohë nga Inspektorati.

Besim Beqaj tha se çështjet e inspektimit janë të rregulluara me Ligjin për minierat dhe mineralet dhe propozoi që mos të ceken afatet e inspektimeve, por të mbetet sikurse në atë ligj, pra të shënohet “*Inspektimet të bëhen konform ligjit për minierat dhe mineralet*”.

Propozimi i deputetit Beqaj dhe përfaqësuesit të minsitrisë u miratuan.

Pas debatit, Komisioni njëzëri, nxori këtë:

P ë r f u n d i m

1. Miratohet nisma legjislative “Projektligji për sigurinë në punë në veprimtarinë minerare” i hartuar nga vetë Komisioni;

2. Projektligji t’i dërgohet Kryesisë që ta procedojë projektligjin për Qeverinë për dhënien e mendimit për projektligjin Projektligji për sigurinë në punë në veprimtarinë minerare.

7. Të ndryshme

a) **Kryetari Mustafa** tha se ai dhe z. Beqaj jemi ftuar në një tryezë me temën “Energjia, Demokracia, Zhvillimi: Sa mundet dialogu politik të sigurojë shfrytëzim të qëndrueshëm të energjisë dhe mbrojtjen e mjedisit në Evropën Jug- Lindore?” që do të mbahet më 29-30 shtator 2015 në Podgoricë, Mal të Zi. Për këtë tryezë e propozoi z. Blerim Graincën të marrë pjesë në vend të tij dhe z. Beqaj i cili është i ftuar.

b) Lidhur me mbledhjen e ardhshme z. Mustafa i njoftoi deputetët se do të diskutohet për çështjen e industrisë së qumshtit, tashmë janë bërë dy analiza, një nga eksperti i angazhuar dhe një nga Instituti INDEP, të cilat do të na shërbejnë për nxjerrjen e rekomandimeve.

Propozimet e kryetarit u përkrahën nga Komisioni.

Mbledhja përfundoi në orën 12:45.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa